



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ р./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtruesi i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 74-të, të mbajtur më 05.09.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Procedura sipas lëndës me nr. 12 - 3066/1 datë 27.08.2021, e formuar pas një denoncimi me pretendime për parregullsi në procedurën e përzgjedhjes së mësuesit të arsimit figurativ në SHFK "-----, -----, **NDËRPRITET.**

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprime të mëtejshme, sepse rasti në fjalë është trajtuar nga një autoritet tjetër kompetent dhe nuk janë konstatuar parregullsi në lidhje me akuzat e denoncuar.

Lënda me numër 12 - 3066/1 të datës 27.08.2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga ana e një parashtruesi të njohur është dorëzuar denoncim me numër 12 - 3066/1, datë 27.08.2021, pas së cilës është hapur rasti në KSHPK me pretendimet për parregullsi në procedurën e përzgjedhjes së një mësuesi në SHFK"-----, -----, sipas një shpallje të publikuar më 27.07.2021 në gazeta e përditshme "Veçer". Në kërkesë thuhet se parashtruesi, ----- nga -----, dërgoi një kundërshtim në shkollë dhe në Inspektoratin Shtetëror Arsimor të RMV-së.

Me qëllim kontrollimin e pretendimeve në fjalë dhe dhe konstatimin e gjendjes faktike në këtë çështje, KSHPK-ja ka kërkuar informacion dhe të dhëna nga Inspektorati Shtetëror Arsimor, në lidhje me trajtimin kompetent të tyre për rastin në fjalë. Pas kërkesës është marrë informacioni i kërkuar, me dokumentacion të bashkëngjitur dhe pas inspektimit të të njëjtës, KSHPK-ja ka konstatuar se në shkollën fillore në fjalë është kryer një inspektim i jashtëzakonshëm nga Inspektorati Shtetëror Arsimor në datën 17.01.2022. dhe është përpiluar procesverbal, i cili nuk ka konstatuar parregullsi gjatë zgjedhjes së mësuesit për lëndën artit figurativ. Në bazë të konstatimit sa me sipër, inspektorati shtetëror arsimor e ka ndërprerë procedurën pas mbikëqyrjes.

Bazuar në sa më sipër, KSHPK-ja konstatoi se lënë në fjalë e ka trajtuar një organ tjetër që është kompetent për të vepruar dhe gjatë veprimit të saj nuk janë konstatuar parregullsi në lidhje me pretendimet e denoncuar lidhur me përzgjedhjen e mësuesit, pas së cilës ka konstatuar se nuk kishte elemente për veprime të mëtejshme dhe vendosi se si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI SHETËTORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
KRYETARE,
Biljana Ivanovska

I dorëzohet: parashtruesit të denoncimit
Përgatiti: J.C.
Miratoi: N.B., Anëtar i KSHPK-së

